



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Nr. 3404 Prot.

Tiranë, më 17.10.2022

**Lënda:** “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin Nr. 7/2017, “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme.””

**Drejtuar:** Znj. LINDITA NIKOLLA  
KRYETARE KUVEDIT TË SHQIPËRISË

**E nderuar zonja Kryetare,**

Bazuar në nenin 81, pika 1, “Kushtetuta së Republikës së Shqipërisë”, si edhe në nenin 68, të Rregullores së Kuvendit, paraqes për shqyrtim dhe miratim në Kuvend të projektligjit “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin Nr. 7/2017 , “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme.”

Bashkëlidhur gjeni tekstin e projektligjit dhe relacionin përkatës.

Duke ju falenderuar për mirëkuptimin.

**Deputeti propozues**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

**PROJEKTLIGJ**

Nr. \_\_\_\_/2022

**“PËR  
DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN 7/2017 “PËR NXITJEN E  
PËRDORIMIT TË ENERGJISË NGA BURIMET E RINOVUESHME.”**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI  
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**VENDOSI:**

Në ligjin nr. 7/2017 “Për Nxitjen e Përdorimit të Energjisë nga Burimet e Rinovueshme.”, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

**Neni 1**

Në nenin 3, pika 1 gërma “I” “Skema e matjes së energjisë neto”, fjalët “nën 500 kW” zëvendësohen me fjalët “2 MW”.

**Neni 2**

Në nenin 15 bëhen shtesat dhe ndryshimet si më poshtë vijon:

Pika 1 ndryshohet si vijon:

1. Në përputhje me skemën e matjes, një shoqëri e vogël ose e mesme apo një klient familjar mund të instalojë një kapacitet total deri në 2 MW për prodhimin e energjisë elektrike nga era ose dielli për të mbuluar një pjesë ose të gjithë energjinë që nevojitet për nevojat e tij dhe të injektojë energjinë e tepërt të prodhuar në rrjetin e shpërndarjes.

Pika 3 ndryshohet si vijon:

3. Bilanci neto bëhet në baza vjetore, ndërsa faturimi bëhet në baza mujore për secilën pikë matje. Teprica e energjisë elektrike më e madhe se konsumi mujor i shitet furnizuesit të shërbimit universal, i ngarkuar me detyrimin e shërbimit publik sipas çmimit të miratuar nga ERE në përputhje me metodologjinë e miratuar nga Këshilli i Ministrave, me propozimin e Ministrit. Metodologjia përcakton kriteret e llogaritjes së çmimit, duke u bazuar në çmimin e

tregut të organizuar të energjisë elektrike ose deri në krijimin e tij, në çmime të krahasueshme të tregjeve të organizuara të vendeve fqinje, plus një bonus të caktuar për promovimin e këtyre burimeve, i cili merr në konsideratë një kthim të arsyeshëm të vlerës së investimeve. Në çdo rast, ky çmim nuk do të jetë më i ulët se çmimi i miratuar nga ERE në vitin 2016.

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYETAR**

**LINDITA NIKOLLA**



## RELACION PËR PROJEKTLIGJIN

“PËR

**DISA SHITESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 7/2017, “PËR NXITJEN E PËRDORIMIT TË ENERGJISË NGA BURIMET E RINOVUESHME.”**”

Shqipëria ka nevojë të jashtëzakonshme për burime të reja për plotësimin e nevojave të saj në rritje për energji elektrike. Kapaciteti aktual i instaluar për prodhimin e energjisë është 2607MW dhe nga centralet fotovoltaike është 23 MW.

Nderkohe që realizimi i objektivave sipas planit kombëtar të veprimit për burimet e rinovueshme të energjisë të miratuar me vendim nr. 580 datë 28.08.2019, rritjen e kontributeve të energjise se rinovueshme, duke përjashtuar kaskaden e Drinit, nuk janë përbushur.

Qeveria me udhëzimet e nxjerra ka frenuar dhe nuk ka stimuluar që konsumatorët të plotësojnë kërkesën e tyre për energji nepermjet veteprodhimit. Sektori banesave dhe tregëtisë përben 37% të konsumit final të energjisë të llogaritur në sipas sektorëve. Studimet për Hartimin e Kostove të Kapitalit për energjinë diellore në Shqipëri, sipas potencialit PV (Plani Vjetor) me një mesatare prej 1500 kWh/kWp për një impiant fotovoltaiq 2MW provojnë qartazi se këto investime do të vetshlyeshin për 4 vjet.

Qeveria është dorezuar ndaj varesisë hidrike të prodhimit të energjisë elektrike dhe efekteve të pafavorshme gjatë muajve të verës.

Ligji 43/2015 për sektorin e energjisë elektrike përcakton të drejtën e konsumatorit familjar mbi shërbimin universal të furnizimit, si detyrim i shërbimit publik, furnizojnë vetëm klientët fundorë, brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, me çmime të rregulluara, lehtësisht dhe qartësisht të krahasueshme, transparente dhe jodiskriminuese, sipas kushteve të përcaktuara nga ERE.

Çmimet e energjisë, objekt rregullimi, për qëllim të shërbimit universal të furnizimit, reflektojnë kostot e përcaktuara në metodologjitë përkatëse.

ERE përcakton afatin e aplikimit të çmimeve të rregulluara për kategoritë e caktuara të klientëve dhe rishikon mbi baza vjetore nivelin e çmimit të miratuar.

Vendosja e fashës mbi 800kw/h u miratua ishte në kundërshtim me Direktivën e Energjisë Elektrike dhe de-rregullimit, Nenit 83, 85, 21 të ligjit të sektorit energjetik dhe tregon qartë mungesën e vizionit dhe strategjisë mbi këtë sektor, duke mos kuptuar objektivat e vendosura në Planin Kombëtar të Veprimit, Strategjinë Kombëtare të Energjisë, ligjin 43/2015.

Shembull i qarte eshte Neni 78 Sistemet matëse inteligjente, "Operatori i sistemit të shpërndarjes, brenda 1 viti nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji, përgatit vlerësimin ekonomik i cili duhet të marrë në konsideratë të gjitha kostot afatgjata dhe përfitimet që do të ketë tregu dhe klientët, duke përfshirë gjithashtu edhe formën e matjes inteligjente që do të përzgjidhet, e cila duhet të jetë ekonomikisht më efektive dhe me afatin kohor më të përshtatshëm për implementimin e këtij sistemi matjeje. Operatori i sistemit të shpërndarjes

përgatit një kalendar për implementimin brenda një periudhë 10-vjeçare të sistemeve inteligjente të matjes, i cili miratohet nga ministri përgjegjës për energjinë"

Liberalizimi i tregut dhe motivimi për pjesëmarrjen e bizneseve dhe ekonomive familjare në investime dhe gjenerim energjie për nevojat e tyre, mund të sjellë një përmirësim të shpejtë të situatës.

Propozimi për mundësinë e futjes në rrjet me pagese të energjisë së gjeneruar nga impiantet fotovoltaike familjare, dhe subvencionimi i ndertimit të tyre, do të krijojë një realitet të ri të konsumit dhe të kursimit të energjisë nga çdo ekonomi shtëpijake.

Pasoje pozitive do të jete edhe ulja e ngarkesës në rrjet dhe krijimi i mundësive për uljen e humbjeve të rrjetit që aktualisht shkojnë rreth 20 %.

Për këtë, nevojiten këto ndryshime perkatëse në ligjin nr. 7/2017 "Për Nxitjen e Përdorimit të Energjisë nga Burimet e Rinovueshme" që po paraqesim për shqyrtim e miratim në Kuvendin e Shqipërisë.

Eshtë në kompetencën e Ministrisë, por si rrjedhojë janë imperative dhe shumë domosdoshme ndryshime edhe në Udhëzimin nr.3 datë 20.06.2019 të Ministrisë të Energjisë dhe Infrastruktura "Për Miratimin e Procedurës së Lehtësuar të Autorizimit për Lidhjen në Sistemin e Shpërndarjes të Projekteve të Vogla të Rinovueshme për Vetëprodhuesit të Energjisë Elektrike nga Dielli" ku do të duhet shfuqizohet pika 17 e Udhëzimit e cila parashikon:

"Deri në miratimin e Metodologjisë së përcaktimit të çmimit të blerjes së energjisë elektrike të prodhuar, teprica e energjisë, që tejkalon konsumin mujor, do t'i kalojë Furnizuesit të Shërbimit Universal pa kundërshpërblim për vetëprodhuesit".